

RAPORTI I TRANSPARENCËS VITI 2024

në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"

Zhaneta Luca
Auditues Ligjor



1. Hyrje

Ky raport është përgatitur në zbatim të nenit 45 të ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, dhe paraqet mënyrën e organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së ProActive Solutions gjatë vitit 2024.

Veprimtaria profesionale është ushtruar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë (SNMC 1 dhe SNMC 2), SNA 220 (i rishikuar), Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël, përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë, si dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme në Shqipëri.

ProActive Solutions, e regjistruar me NUIS M41326027U dhe e drejtuar nga Zhaneta Luca, Auditues Ligjor, funksionon si një praktikë e organizuar nga një auditues ligjor i vetëm dhe nuk ka auditues të tjerë ligjorë në strukturën e saj. Veprimtaria e auditimit dhe shërbimet e lidhura mbështeten nga personel profesional dhe staf ndihmës, në përputhje me natyrën dhe përmasat e angazhimeve të marra përsipër.

Organizimi i brendshëm është i thjeshtë dhe pa nivele hierarkike formale. Personeli bashkëpunon në mënyrë funksionale dhe raporton drejtpërdrejt tek Audituesi Ligjor, i cili mban përgjegjësinë përfundimtare për drejtimin dhe cilësinë e angazhimeve, si dhe për hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në nivel firme.

2. Struktura ligjore, pronësia dhe drejtimi

ProActive Solutions është një praktikë profesionale e organizuar dhe drejtuar nga një Auditues Ligjor, e regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së auditimit ligjor dhe të shërbimeve të lidhura, në përputhje me legjislacionin dhe kërkesat profesionale në fuqi. Të dhënat kryesore identifikuese dhe profesionale paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Të dhëna identifikuese	Informacioni
Auditues ligjor	Zhaneta Luca
Numri në Regjistrin Publik	466
Data e regjistrimit si auditues ligjor	06.11.2020
Forma ligjore	Person fizik
Emri tregtar	ProActive Solutions
NUIS	M41326027U
Data e regjistrimit në QKB	26.01.2024
Adresa	Rruga Selitë e Vjetër, ZK 3292, Farkë, Tiranë
Kontakt	office@proactives.al 068 405 6669

3. Rrjeti dhe marrëdhëniet profesionale

ProActive Solutions nuk është pjesë e një rrjeti kombëtar apo ndërkombëtar firmash auditimi dhe nuk ka marrëveshje për ndarjen e pronësisë, drejtimit, kontrollit, emrit tregtar apo burimeve profesionale me subjekte të tjera audituese.

Kur natyra ose përmasat e një angazhimi kërkojnë njohuri të specializuara apo burime shtesë, Firma mund të bashkëpunojë me profesionistë të jashtëm, duke vlerësuar paraprakisht kompetencën, objektivitetin, konfidencialitetin dhe pavarësinë e tyre. Këto bashkëpunime realizohen për angazhime të veçanta dhe nuk përbëjnë marrëdhënie rrjeti.

4. Veprimtaria profesionale dhe mënyra e realizimit të angazhimeve

Gjatë vitit 2024, ProActive Solutions ka ushtruar veprimtari në fushën e auditimit ligjor, kontabilitetit, përgatitjes së pasqyrave financiare, këshillimit tatimor dhe shërbimeve të tjera të lidhura. Shërbimet janë ofruar në përputhje me objektin e secilit angazhim dhe me kërkesat ligjore dhe profesionale të zbatueshme.

Në angazhimet e auditimit, qëllimi i Firmës është sigurimi i evidencës së mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur opinionin mbi pasqyrat financiare. Puna kryhet me skepticizëm dhe gjykim profesional, duke ruajtur komunikim të qartë me drejtimin dhe, sipas rastit, me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Për shërbimet e kontabilitetit, përgatitjes së pasqyrave financiare dhe këshillimit tatimor, natyra dhe kufijtë e punës përcaktohen në marrëveshje me klientin. Këshillimi mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe në informacionin e vënë në dispozicion, ndërsa vendimmarrja dhe përgjegjësia për zbatimin e tij i mbeten drejtimit të klientit.

Kur një klient auditimi kërkon shërbime të tjera profesionale, Firma vlerëson paraprakisht lejueshmërinë e tyre dhe ndikimin e mundshëm në pavarësi. Shërbimet pranohen vetëm kur nuk cenojnë objektivitetin e Audituesit Ligjor dhe nuk përfshijnë marrjen e përgjegjësi të drejtimit.

5. Sistemi i menaxhimit të cilësisë

ProActive Solutions ka hartuar dhe zbaton një sistem të menaxhimit të cilësisë të përshtatur me natyrën dhe përmasat e veprimtarisë së saj, në përputhje me kërkesat e SNMC 1, SNA 220 (i rishikuar) dhe, kur është i zbatueshëm, SNMC 2. Sistemi synon të sigurojë që Firma dhe personeli i saj përmbushin përgjegjësitë profesionale, ligjore dhe rregullatore dhe që raportet e lëshuara janë të përshtatshme për rrethanat e angazhimit. Duke qenë një praktikë e organizuar nga një auditues ligjor i vetëm, përgjegjësinë përfundimtare për hartimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit e mban Audituesi Ligjor. Audituesi Ligjor përfshihet drejtpërdrejt në fazat kryesore të angazhimeve dhe është përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e punës së kryer.

Sistemi është ndërtuar duke marrë në konsideratë profilin e klientëve, llojin dhe kompleksitetin e shërbimeve të ofruara dhe burimet profesionale të angazhuara. Ai përfshin respektimin e kërkesave etike dhe të pavarësisë, pranimin dhe, kur është e zbatueshme, vijimin e marrëdhënieve me klientët, realizimin e angazhimeve, sigurimin e burimeve të përshtatshme, konsultimin për çështjet që kërkojnë gjykim të rëndësishëm, si dhe dokumentimin dhe rishikimin e punës së kryer.

Kur natyra ose kompleksiteti i një angazhimi kërkon njohuri të specializuara apo një vlerësim të pavarur shtesë, Firma mund të angazhojë profesionistë të jashtëm, pasi të ketë vlerësuar kompetencën, objektivitetin, pavarësinë dhe detyrimin e tyre për ruajtjen e konfidencialitetit.

Politikat dhe procedurat e sistemit janë dokumentuar në Manualin e Menaxhimit të Cilësisë dhe zbatohen në nivel firme dhe angazhimi, në përputhje me natyrën dhe përmasat e veprimtarisë së ProActive Solutions. Funksionimi i sistemit monitorohet dhe vlerësohet periodikisht, duke marrë në konsideratë çështjet e evidentuara gjatë angazhimeve, rezultatet e rishikimeve dhe gjetjet që mund të rezultojnë nga kontrollet e jashtme, si dhe ndryshimet në standardet profesionale dhe kërkesat ligjore.

Në bazë të vlerësimit të kryer për periudhën raportuese, Audituesi Ligjor vlerëson se sistemi i menaxhimit të cilësisë i siguron Firmës një bazë të arsyeshme për arritjen e objektivave të cilësisë dhe funksionon në përputhje me natyrën dhe përmasat e veprimtarisë së saj.

6. Etika, pavarësia dhe konfidencialiteti

ProActive Solutions ushtron veprimtarinë në përputhje me parimet themelore të etikës profesionale: integritetin, objektivitetin, kompetencën dhe kujdesin e duhur profesional, konfidencialitetin dhe sjelljen profesionale. Këto parime zbatohen nga Audituesi Ligjor, personeli dhe profesionistët e jashtëm të përfshirë në angazhime.

Përpara pranimit të çdo angazhimi auditimi identifikohen dhe vlerësohen marrëdhëniet, interesat ose rrethanat që mund të krijojnë kërcënime ndaj pavarësisë dhe objektivitetit. Kur evidentohen kërcënime të tilla, vlerësohet rëndësia e tyre dhe merren masat e nevojshme për eliminimin ose zvogëlimin e tyre në një nivel të pranueshëm. Nëse kjo nuk është e mundur, angazhimi nuk pranohet ose ndërpritet, sipas rastit. Audituesi Ligjor dhe personeli i përfshirë në angazhimet e auditimit konfirmojnë respektimin e kërkesave të pavarësisë dhe njoftojnë pa vonesë çdo rrethanë që mund të ndikojë në pavarësinë ose objektivitetin e tyre. Këto çështje vlerësohen jo vetëm në fillim të angazhimit, por gjatë gjithë periudhës së realizimit të tij. Kur për një klient auditimi ofrohen ose kërkohen shërbime të tjera profesionale, natyra dhe ndikimi i tyre vlerësohen paraprakisht. Shërbimet pranohen vetëm kur lejohen nga kërkesat ligjore dhe profesionale, nuk përfshijnë marrjen e përgjegjësi të drejtimit dhe nuk cenojnë pavarësinë e Audituesit Ligjor. Kur është e nevojshme, zbatohen masa mbrojtëse të përshtatshme ose shërbimi nuk pranohet.

Informacioni dhe dokumentacioni i siguruar gjatë marrëdhënieve profesionale trajtohen si konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllimet e angazhimit përkatës. Aksesit në dokumentacion u jepet vetëm personave të autorizuar. Informacioni nuk u bëhet i ditur palëve të treta pa autorizimin e klientit, përveç rasteve kur kjo kërkohet ose lejohet nga ligji, standardet profesionale apo autoritetet kompetente. Firma zbaton masa për ruajtjen, mbrojtjen dhe arkivimin e dokumentacionit profesional, me qëllim parandalimin e aksesit të paautorizuar, ndryshimit, humbjes ose përdorimit të papërshtatshëm të tij. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pas përfundimit të angazhimit ose të marrëdhënieve profesionale.

Gjatë periudhës raportuese, kërkesat për pavarësinë janë vlerësuar në kuadër të pranimit dhe realizimit të angazhimeve. Nuk janë evidentuar rrethana ose marrëdhënie që cenojnë pavarësinë e Audituesit Ligjor. Firma vlerëson se politikat dhe procedurat e vendosura ofrojnë një bazë të arsyeshme për respektimin e kërkesave etike dhe të pavarësisë.

7. Pranimi dhe realizimi i angazhimeve

Përpara pranimit të një angazhimi, ProActive Solutions vlerëson integritetin e klientit, natyrën dhe objektin e shërbimit, kërkesat etike dhe të pavarësisë, si dhe disponueshmërinë e kompetencës, kohës dhe burimeve të nevojshme. Kushtet e angazhimit dokumentohen në marrëveshjen përkatëse. Për auditimet fillestare kryhet edhe komunikimi me audituesin paraardhës, kur është i zbatueshëm.

Angazhimet e auditimit planifikohen dhe realizohen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Natyra, koha dhe shtrirja e procedurave përcaktohen mbi bazën e njohjes së njësisë ekonomike dhe vlerësimit të rreziqeve për anomali materiale. Audituesi Ligjor përfshihet drejtpërdrejt në fazat kryesore, drejton dhe mbikëqyr personelin e angazhuar dhe rishikon dokumentacionin e punës.

Çështjet e rëndësishme dhe nevojat për informacion shtesë komunikohen në kohë me drejtimin dhe, sipas rastit, me personat e ngarkuar me qeverisjen. Kur nevojiten njohuri të specializuara, kryhen konsultime me profesionistë të përshtatshëm. Raporti lëshohet vetëm pasi të jenë trajtuar çështjet e rëndësishme dhe të jetë siguruar evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbështetjen e përfundimit të angazhimit.

8. Burimet njerëzore dhe zhvillimi profesional

Firma organizon burimet njerëzore në përputhje me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e angazhimeve të saj. ProActive Solutions ushtron veprimtarinë si praktikë e organizuar nga një auditues ligjor i vetëm, i cili mban përgjegjësinë për drejtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e punës së kryer në çdo angazhim. Në realizimin e angazhimeve mund të përfshihet edhe personel mbështetës, të cilit i caktohen detyra në përputhje me njohuritë, aftësitë dhe përvojën profesionale.

Përpara caktimit të detyrave vlerësohen natyra dhe kompleksiteti i punës, koha e nevojshme për realizimin e saj, si dhe niveli i drejtimit dhe mbikëqyrjes që kërkohet. Audituesi Ligjor ndjek në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e punës, shqyrton çështjet e evidentuara dhe rishikon dokumentacionin përpara përfundimit të angazhimit.

Firma mbështet zhvillimin profesional dhe përditësimin e vazhdueshëm të njohurive në përputhje me standardet profesionale, kërkesat ligjore dhe rregullatore, si dhe praktikën e zbatueshme. Nevojat për trajnim identifikohen duke marrë në konsideratë përgjegjësitë e caktuara, ndryshimet në kuadrin profesional dhe çështjet e hasura gjatë realizimit të angazhimeve.

Përvoja e përfutur gjatë realizimit të angazhimeve përdoret për përmirësimin e vazhdueshëm të organizimit të punës, përcaktimit të përgjegjësisë dhe mënyrës së dokumentimit të saj. Përfundimet e nxjerra merren në konsideratë gjatë planifikimit të angazhimeve të ardhshme dhe përshtatjes së procedurave me natyrën dhe rrethanat e tyre.

9. Kontrolli i sigurimit të cilësisë

ProActive Solutions është subjekt i sistemit të kontrollit të sigurimit të cilësisë, të organizuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi për auditimin ligjor.

Në kuadër të këtij procesi, Firma bashkëpunon me BMP-në dhe vë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar. Gjetjet dhe rekomandimet që mund të rezultojnë nga kontrolli vlerësohen nga Audituesi Ligjor dhe, sipas rastit, merren masat e nevojshme për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe të mënyrës së realizimit të angazhimeve.

Deri në datën e publikimit të këtij raporti, ProActive Solutions nuk ka qenë objekt i një kontrolli të sigurimit të cilësisë nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

10. Njësitë me interes publik të audituara

Gjatë vitit 2024, ProActive Solutions ka kryer auditimin ligjor të pasqyrave financiare të njësisë me interes publik të paraqitur më poshtë:

Njësia ekonomike	NUIS	Pasqyrat financiare
Proton Communication Sh.p.k.	L42008005H	Viti i mbyllur më 31.12.2023

11. Informacioni financiar dhe baza e shpërblimit

Të ardhurat e vitit 2024, të rakorduara me raportimin vjetor të angazhimeve, paraqiten më poshtë. Shumat janë pa TVSH dhe në mijë Lekë.

Kategoria e të ardhurave	ooo Lekë
Auditim ligjor i njësive ekonomike me interes publik	300,0
Auditim ligjor i njësive të tjera	1.054,0
Kontabilitet dhe përgatitje e pasqyrave financiare	3.742,5
Këshillime tatimore dhe shërbime të tjera joauditimi	2.849,0
Gjithsej	7.945,5

Duke qenë se veprimtaria ushtrohet nga një auditues ligjor person fizik dhe nuk ka ortakë angazhimi, nuk zbatohet një skemë shpërblimi për ortakët. Të ardhurat nga veprimtaria i përkasin personit fizik, ndërsa tarifën e angazhimeve përcaktohen duke marrë parasysh natyrën, kompleksitetin, nivelin e riskut, kohën dhe burimet e nevojshme për kryerjen e punës, pa u kushtëzuar nga rezultati i auditimit.

12. Deklaratat përfundimtare

Në lidhje me periudhën raportuese, Audituesi Ligjor deklaron se:

- është kryer vlerësimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë së Firmës dhe, në bazë të këtij vlerësimi, sistemi siguron një bazë të arsyeshme për arritjen e objektivave të cilësisë, në përputhje me natyrën dhe përmasat e veprimtarisë së ProActive Solutions;
- kërkesat për pavarësinë janë vlerësuar në kuadër të pranimit dhe realizimit të angazhimeve dhe nuk janë evidentuar rrethana ose marrëdhënie që cenojnë pavarësinë e Audituesit Ligjor;
- është zbatuar politika e Firmës për edukimin e vijueshëm profesional dhe Audituesi Ligjor ka përmbushur kërkesat përkatëse të kualifikimit profesional.

Informacioni i paraqitur në këtë raport pasqyron strukturën, organizimin dhe veprimtarinë e ProActive Solutions për periudhën raportuese dhe është përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore dhe profesionale të zbatueshme për raportin e transparencës.

Tiranë, 31 mars 2025

Zhaneta Luca
Auditues Ligjor

Nr. licence: 466
M41326027U
Rruga Selitë e Vjetër, Tiranë